



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC
01 Nr. 501-1682
Më
On. 3.06.2010



Në mbshtetje të nenit 432 të ligjit për vetqeverisjen lokale Nr 03/L040, si dhe të nenit 36 të statutit të komunes, kuvendi komunal në seancën e mbajtur më 30.05.10 miratoi këtë :

RREGULLORE KOMUNALE PËR MBROJTJËN E MJEDISIT NE TERITORIN E KOMUNËS SE DRENASIT

Neni 1

Kjo propozim rregullore ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit për territorin e Komunës tonë nga ndotja, një mjedis i tillë formohet konformë një zhvillimi të qëndrueshem ekonomik.

Neni 2

Ne këtë nën të kësaj rregullore përfshihen termet e përdorura në këtë rregullore si: perkufizimet e organeve udhëheqëse, termet për dëmtimet e mjedisit, pelqimi, vlerësimi, inspektorati i mjedisit, lejen e mjedisit, qrrregullimin e madh mjedisor, aktet normative, aktet plotësuese normative, akti i veçant, liqensa, autorizimi, autoritetet publike, shërbimet publike, burimet natyrore me vlerë, riciklimi, sanimi, cilësia e mjedisit, kadastrin e ndotësve,

Neni 3

Të gjithë operatorët lokal të cilët veprojnë në territorin e komunës dhe të cilët konsiderohen ndotës të mjedisit janë të obliguar që të bëjnë menagjimin e operatorve të tyre sipas standarteve europiane dhe të krijojnë kushte sa më të mira për parandalimin e ndotjes së mjedisit aty ku e ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Neni 4

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë reale dhe të përballueshme nga autoritetet publike, personat dhe ndërmarrjet konformë zhvillimit të qëndrueshem ekonomik, zvoglimi i ndotjes, degradimi, dëmi mjedisor, aktivitetet që përbëjnë rrezik për jetën e njeriut dhe mjedisit, biodiversiteti, shfrytëzimi jo racional i resurseve natyrore, mbrojtja e pamjës së natyrës dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe historike.

Zvoglimi i ndotjës ,degradimi ,dëmi mjedisor ,aktivitetet qe përbëjnë rrezik për jetën e njeriut dhe mjedisit ,biodiversiteti ,shfrytëzimi jo racional i resurseve natyrore ,mbrojtja e pamjës se natyrës dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe historike.

Neni 5

Autoriteti publik është i autorizuar me dispozitë ligjore apo akte normative plotësues të implementojë ose të adaptoi këtë rregullore ku do ti kryej detyrat në bazë të parimeve udhëzuese siq janë:

- Balansimi i mbrojtjës se mjedisit dhe nevojës për zhvillim ekonomik
- Parimi i ruajtjës së objekteve kulturo-historike dhe burimve natyrore me vlerë
- Integrimi gradual i mbrojtjës se mjedisit
- Vigjilenca dhe parandalimi
- Parimi i ripërdorimit ,riciklimit si dhe substitiuimit të kemikalev(ndotësi paguan dhe shfrytëzuesi paguan).
- Përgjegjësia e pronarit trashigimtar të pronës
- Sigurimi i detyruar
- Masat inkurajuese
- Parimi i mbrojtjës se të drejtave në gjykatë si dhe,
- Parimi i informimit publik ,ku të gjithë personat kanë të drejt të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit.

Neni 6

Bashkpunimi me Ministrinë për përgaditjen e planit për mbrojtjen e mjedisit brenda teritorit të komunës se Drenasit në përputhshmeri me ligjin në fuqi.

-Përgadisim dhe sigurojm informata për qytetaret në lidhje me mbrojtjen e mjedisit
-Formimi i komisionit të ekspertëve nga Kuvndi komunal për hartimin e planit për mbrojtje të mjedisit i cili plan duhet të aprovohet nga Kuvendi Komunal i Drenasit.

Neni 7

Mbrojtja e mjedisit rregullohet me:

-Zbatimin i ligjit për mbrojtje të mjedisit si dhe akteve tjera që do të harmonizohen në përputhshmeri me ligjin nga ana e Kuvendit Komunal të Drenasit.

Neni 8

Të gjitha institucionet jan të obliguara që të marrin pelqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjës dhe rehabilitimit mjedisor, të cilin pelqim në këtë rast e jep ministria.

Neni 9

Personat juridik dhe fizikë të cilët shfrytëzojn resurset natyrore janë të detyruar që të parandalojn ndotjen e mjedisit gjatë aktiviteteteve të veta si dhe pas përfundimit të punimeve të bejnë sanimin e mjedidit të dëmtuar (këthimi në gjendjen e mëparme).

Neni 10

Me këtë nen parashihet mbrojtja e vlerave natyrore në komunën e Drenasit, të cilat vlera janë të mbrojtura me vendim të Kuvendit komunal si dhe nga instituti për mbrojtjen e objekteve natyrore me vlera të veqanta.

-Mbrojtja e shfrytëzimit të hapsirave brenda vendeve të caktuara

-Siperfaqet publike të gjelbëruara të cilat siperfaqe përfshihen edhe me planet zhvillimore Komunale dhe Urbane të Drenasit

Neni 11

Mbrojtja dhe ruajtja e përbërësve të mjedisit: tokës, ujit, ajrit rregullohet me ligje të veqanta të aprovuara.

Neni 12

Duke marrë për bazë nenin 6 të kësajë rregullore për hartimin e planit lokal të veprimit në mjedis (PLVM), duhet të hartohen dhe programe për mbrojtjen e mjedisit e që në hartimin e këtyre planeve dhe programeve marrin pjesë Publiku, OJQ-ët Organizata profesionale dhe Komuniteti i biznesit.

KREU I II

MASAT DHE KUSHTET PËR MBROJTJËN E MJEDISIT

Neni 13

Përcakton planet hapsinore ku sigurohen masat dhe kushtet për mbrojtjen e mjedisit si:

-Kriteret e veqanta për ruajtjen vlerave të kulturës dhe të natyrës, burimet e furnizimit me ujë, ujrat termale dhe minerale, pyjet, tokat bujqësore etj.

-Përcaktohen zonat e ndotura dhe zonat e rrezikuara nga erozionet dhe përmbytjet, zonat për eksploatim të resurseve natyrore, vend ndërtimet për objekte industriale dhe energjetike si dhe ndërtimi i infrastrukturës dhe objekteve tjera shfrytëzimi i të cilave mund të rrezikoi mjedisin.

Neni 14

Vlerësimi të ndikimit në mjedis (VNM) i nënështrohen të gjitha projektet nga lëmenj të: industrisë, xehtarisë, energjetikës, komunikacionit, turizmit, bujqësisë, pylltarisë, ujrave dhe veprimtarive tjera komunale që planifikohen në zonat e caktuara dhe që kanë ndikim në mjedis.

Neni 15

Obligon të gjithë aplikantët për leje ndërtimi që para fillimit të punimeve për ndërtim të aplikojnë për leje mjedisore komunale e që për këtë përcakton edhe neni 32 i ligjit për mbrojtje të mjedisit,

Neni 16

Nëse personi juridik ose fizikë ka shkaktuar dëm mjedisor me qellim ose nga pakujdesia e cila rezulton me qrrregullime mjedisore është i detyruar ta kthej pjesën e dëmtuar në kushtet që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut e që duhet të merren masa rehabilituese për pjesën e dëmtuar.

Në rast se pala shkakton dëm mjedisor është i obliguar që sanimin e dëmit ta bëjë me mjetet e veta, mvarsisht se si vlerësohet nga komisioni.

Neni 17

Në rast të aksidentit të mundshëm mjedisor që rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për teritorin e vet.

Neni 18

Komuna e njofton publikun për marrjen e masave të veqanta në raste të rrezikut të drejt për drejt të ndotjes se mjedisit dhe këtë e bënë paraprakisht.

Neni 19

Qdo person që është i njoftuar për dëmtim të mjedisit ose për aksident mjedisor duhet të njoftoi inspektorin ose organin përgjegjës për mbrojtje të mjedisit.

Neni 20

Në rast të aksidentit mjedisor mvarsisht nga përmasat që shkaktojnë rrezik të drejt për drejt ose të terthort për mjedisin dhe shëndetin e njeriut komuna e shpallë gjendjen e mjedisit të rrezikuar dhe për këtë e njofton publikun për masat që do të ndermirrën

KREU I III MONITORIMI DHE INFORMIMI PËR MJEDISIN

Neni 21

Komuna në kuadër të përgjegjësi të veta që ka siguron kontrollin e vazhdueshëm dhe bënë monitorimin e gjendjes se mjedisit në përputhshmeri me ligjin në fuqi.

Monitorimi i mjedisit kryhet përmes matjeve sistematike, hulumtimit dhe vlerësimit të indikatorve të gjendjes dhe ndotjes se mjedisit të cilët përfshijnë përcjelljen e faktorëve natyror, përfshirë monitorimin e ajrit, ujit, tokës, pyjeve etj. Informacioni duhet të jetë publik dhe të gjitha të dhënat përfshihen në një sistem informativ të mbrojtjes se mjedisit.

-Personat juridik ose fizikë të cilët më veprimtarinë e tyre mund të ndotin mjedisin janë të obliguar që të sigurojnë mjetet financiare për monitorimin e mjedisit.

Neni 22

Komuna është e detyruar që rregullisht dhe me kohë në mënyrë të plot dhe objektive ta informoi publikun për gjendjen e mjedisit , si dhe për masat paralajmëruese të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin ,shëndetin ,dhe jetën e njeriut në përputhshmeri me ligjin.

Neni 23

Dhënja e informacionit për mbrojtjen e mjedisit ipet sipas kërkesës e që për këtë organi përgjegjës për mbrojtje të mjedisit është i obliguar që brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës ti ipet informacioni parashtruesit të kërkesës, në rast se informata është voluminoze dhe don kohë më të gjatë informata shtyhet për 60 ditë nga dita e pranimi të kërkesës.

Neni 24

Organet vendim marrëse sigurojn pjesëmarrje dhe rol aktiv të publikut gjatë procesit të marrjes së vendimeve për:

- Vlerësimin strategjik mjedisor
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis(VNM)
- Në hartimin e planit lokal të veprimit në mjedis(PLVM)

Kreu IV

DETYRIMET DHE PERGJEGJËSIT PËR NDOTJËN E MJEDISIT

Neni 25

Personat juridik dhe fizik janë të detyruar që gjatë kryerjes së aktiviteteve të tyre të sigurojn mbrojtjen e mjedisit përmes:

- Zbatimit të dispozitave për mbrojtje të mjedisit
- Nderrmarrjen e masave parandaluese ose menjanimi të pasojave dhe rrezikimit të dëmtimit të mjedisit
- Mbajtjen e evidencës sipas procedurës së përcaktuar me ligj
- Kontrollit të aktiviteteve dhe punës së paisjeve të cilat mund të paraqesin rrezik ose mund të shkaktojn rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut,si dhe
- Marrjen e masave tjera në përputhshmeri me ligjin për mbrojtje të mjedisit.

Neni 26

Përgjegjës për ndotjen e mjedisit janë personat juridik dhe fizik për dëmin e shkaktuar për ndotjen e mjedisit, andaj në këtë rast bartin edhe shpenzimet për eliminimin e dëmit të shkaktuar

Neni 27

Secilit person që i shkaktohet dëm mjedisor ka të drejtë në kompenzim, kërkesa për kompenzimin e dëmit mund të parshtrihet drejt për drejt ndotësit të mjedisit, andaj në raste të jashtzakonshme komuna e cila e ka statusin e zonës së rrezikuar mjedisore përcakton kompenzimin për mbrojtjen dhe përmirsimin e mjedisit për qdo person juridik ose fizik që me aktivitetin e vet ndotë mjedisin.

Neni 28

Fondi për mbrojtjen e mjedisit, kompetenca, administrimi, burimet e financimit dhe shfrytëzimi i mjeteve nga fondi do të rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 29

Mbikqyrjen administrative si dhe masat për mbrojtjen e mjedisit e bënë inspektori komunal i mjedisit.

Neni 30

Gjatë inspektimit të veprimtarive dhe aktiviteteve të personave juridik dhe fizik inspektori kërkon nga personi përgjegjës:

- Ti mundësoi kryerjen e mbikqyrjes inspektuese në të gjitha lokalet e punës
 - Të ofroi të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për mbikqyrjen inspektuese
 - Të informoi me marrjen e masave për eliminimin e të metave të konstatuara, andaj mbikqyrjes i nënshtrohen të gjithë personat juridik dhe fizik dhe janë të detyruar që inspektorit të mundësojnë zbatimin e mbikqyrjes inspektuese.
- Inspektori është i detyruar që pas mbikqyrjes inspektuese të hartoi raport dhe të konstatoi gjendjen egzistuese e që një kopje të raportit ia dorëzon personit të cilin është bërë mbikqyrja inspektuese.

Neni 31

Inspektori për mbrojtje të mjedisit pas mbikqyrjes inspektuese merr vendim dhe mund të urdhëroi personin juridik ose fizik që:

- Në afat të caktuar të menjanoi të metat dhe parregullsitë në veprimtaritë dhe aktivitetet për shkak të cilave ka ardhë ose mund të vije deri të ndotja e mjedisit.
- Të ndalojë kryerjen e veprimtarive ose aktiviteteve në procesin e prodhimit, mjeteve dhe paisjeve nga të cilat ka ardhë deri të ndotja e mjedisit.
- Ndalimi i këtyre aktiviteteve bëhet derisa pa rregullsitë në punë të eliminohen.
- Të ndalojë punimet nëse ato kryhen në kundërshtim me masat e përcaktuara nga VNM-ja
- Të ndalojë punët për të cilat nuk është i regjistruar dhe kryerjen e veprimtarisë profesionale për mbrojtje të mjedisit.
- Për faktet e verifikuara gjatë procedurës së inspektimit, gjegjësisht masat e ndërmarra inspektori është i detyruar ta njoftojë personin e paditur.

Më qellim të sigurimit të zbatimit të ndalesave dhe shkeljeve të percaktuara me dispozita tjera, inspektori i mjedisit ka të drejtë dhe obligon qe:

- Pa vonesë të parashtrojë fletëparaqitje organit kompetent për veprën e denueshme
- Fshirjen e veprimtarisë për të cilën vertetohet se personi nuk i plotëson kushtet e parapara me ligj.
- Dhe të ndërmerrë masa tjera për të cilat është i autorizuar

Neni 33

Nëse inspektori gjatë mbikqyrjes inspektuese vleron se përveq shkeljës se dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore, janë shkel edhe dispozitat e ligjeve tjera me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit, është i obliguar qe krahas marrjës se masave për të cilat është i autorizuar, të njoftoi edhe organin tjetër kompetent në mënyrë qe bashkarisht të kryejn mbikqyrjen inspektuese dhe të ndërmarrin masat e parapara me ligj.

Neni 34

Procedura e ankesës

Inspektori në rast të marrjës se masave për urdhresa dhe ndalesa nxjerrë vendim. Në ankesë kundër vendimit të organit kompetent komunal vendos ministria

Neni 35

Dispozitat ndeshkuese

Qdo person juridik ose fizikë qe bënë shkelje për mbrojtje të mjedisit do të ndeshkohet sipas nenit 93,94,dhe 95 të ligjit për mbrojtjen e mjedisit nr.03/L-025-2009 si dhe sipas nenit 17 të udhëzimit administrativ nr.04/2009 për ndeshkimin me gjoba mandatore.

Neni 36

Dispozitat përfundimtare

Komuna është e obliguar që pas hyrjes në fuqi të kësajë rregullore të filloi së zbatuari

- Personat juridik dhe fizikë në komunën e Drenasit janë të obliguar që të zbatojn këtë rregullore

- kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e aprovimit nga asambleja komunale

